



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 1, paragrafi 1, dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2023 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SISTEMIN E PAGESAVE NDËRBANKARE TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Kosovës.
2. Subjektet e zbatimit të kësaj rregullore, janë pjesëmarrësit në Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Bankë** – nënkupton një subjekt të përcaktuar me Ligjin për Bankat;
 - 1.2. **Bankë urdhëruese** – nënkupton një bankë e cila dërgon një urdhër për pagesë për debitimin e llogarisë së saj në sistemin KIPS;
 - 1.3. **Bankë përfituese** – nënkupton një bankë e cila merr një udhëzim pagesë për kreditimin e llogarisë së saj në KIPS;
 - 1.4. **BQK** – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. **BIS (Bank for International Settlement)** – nënkupton Bankën Ndërkombëtare për Shlyerje;
 - 1.6. **ATS (Automated Transfer System)** – nënkupton sistemin ndërbankar të pagesave, i cili përfshinë komponentin RTGS dhe ACH;
 - 1.7. **ACH (Automated Clearing House)** – nënkupton sistemin automatik të kliringut ndërbankar për vlera të vogla të realizuar sipas sesioneve dhe shlyerje në baza neto;
 - 1.8. **Datë e vlefshmërisë** – nënkupton ditën bankare në të cilën realizohet transaksioni i pagesës;
 - 1.9. **DTI** – nënkupton Departamentin e Teknologjisë Informative në BQK;
 - 1.10. **DSP** – nënkupton Departamentin e Sistemeve të Pagesave në BQK;

- 1.11. **DOSP** – nënkupton Divizionin e Operimit të Sistemeve të Pagesave në BQK;
- 1.12. **EUR** – nënkupton valutën EURO;
- 1.13. **E-token** – nënkupton pajisje që mbart një çip të integruar me memorie dhe/ose funksione procesori dhe certifikatë;
- 1.14. **Gridlock** – nënkupton një situatë ngërçi që ndodh me transferat e fondeve ose të letrave me vlerë, në të cilën mos ekzekutimi i një udhëzimi pagese (për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve), bllokon ekzekutimin e një numri pagesash të tjera, të urdhëruara nga pjesëmarrës të tjerë të sistemit;
- 1.15. **Sistem pagesash** – nënkupton një set instrumentesh, procedurash bankare si dhe sistemet e transferimit të transaksioneve ndërbankare që sigurojnë qarkullimin e parasë;
- 1.16. **KIPS (Kosovo Interbank Payment System)** – nënkupton Sistemi i Pagesave Ndërbankare në Republikën e Kosovës;
- 1.17. **Qendra për Vazhdimësi të Biznesit** - nënkupton tërësia harduerike dhe softuerike që shërben në situata emergjente, të jashtëzakonshme kur sistemi primar del jashtë funksionimit;
- 1.18. **ISO** – nënkupton Organizatën Ndërkombëtare për Standardizim;
- 1.19. **PAT** – nënkupton procesimin automatik të transfereve;
- 1.20. **BIC (Bank Identification Code)** – nënkupton kodin e identifikimit të institucioneve pjesëmarrëse në KIPS;
- 1.21. **ILF (Intraday Liquidity Facility)** – nënkupton mbështetje e likuiditetit brenda ditës;
- 1.22. **Likuiditeti** – nënkupton aftësinë paguese të një pjesëmarrësi në sistemin e KIPS;
- 1.23. **Klient** – nënkupton mbajtësin e një llogarie në një bankë;
- 1.24. **Transaksion i pagesave** – nënkupton një veprim të iniciuar nga paguesi ose i paguari, për vendosjen, transferin apo tërheqjen e parave, pavarësisht nga ndonjë obligim përkatës ndërmjet paguesit dhe të paguarit;
- 1.25. **FIFO (First in - First out)** – nënkupton parimin i cili bën vendosjen në radhë të urdhër pagesave, në varësi të momentit të mbërritjes në sistem dhe ku urdhër pagesa e parë e ardhur në radhë shlyhet e para;
- 1.26. **Fonde të mjaftueshme** – nënkupton fondet e disponueshme neto në një llogari shlyerjeje të një pjesëmarrësi në sistemin KIPS, pas shlyerjeve neto të transaksioneve të pagesave;
- 1.27. **RTGS (Real Time Gross Settlement System)** – nënkupton sistemin e shlyerjeve bruto në kohë reale të pagesave me vlera të mëdha dhe urgjente
- 1.28. **PO (Payment Originator)** – nënkupton regjistrimin e transaksioneve në mënyrë manuale nga institucioni që urdhëron pagesën në komponentën e bazuar në ueb të KIPS-it;
- 1.29. **Shlyerje** – nënkupton aktin e shlyerjes së obligimeve me anë të transferit të fondeve, letrave me vlerë apo të instrumenteve të tjera financiare ndërmjet dy ose me tepër palëve;
- 1.30. **Llogari shlyerjeje** – nënkupton llogarinë e një pjesëmarrësi në KIPS e cila përdoret për mbajtjen e fondeve për shlyerjen e pagesave ndërmjet pjesëmarrësve në sistem;
- 1.31. **Log file** – nënkupton historikun e përshkruar të ditës së punës në sistemin KIPS;

- 1.32. **Prerja fillestare** – nënkupton afatin maksimal i përcaktuar në orarin e operimit në sistemin KIPS për pranimin e pagesave për klientët;
- 1.33. **Prerja përfundimtare** – nënkupton afatin maksimal të përcaktuar në orarin e operimit në sistemin KIPS për pranimin e pagesave bankë-bankë;
- 1.34. **Backup** – procesi i ruajtjes së kopjes rezervë të KIPS-it;
- 1.35. **Gateway** – Modul që mundëson shkëmbimin automatik të mesazheve në mes sistemit KIPS dhe sistemeve bazë të pjesëmarrësve;
- 1.36. **Pjesëmarrës në sistem** – nënkupton anëtarin e një sistemi të pagesave të kliringut apo shlyerjes së letrave me vlerë apo palën e një marrëveshje, që themelon një sistem;
- 1.37. **Pjesëmarrës i drejtpërdrejtë** – nënkupton një pjesëmarrës në KIPS, që mund të kryejë të gjitha aktivitetet e lejuara në sistem pa përdorur ndonjë ndërmjetësues;
- 1.38. **Pjesëmarrës jo i drejtpërdrejtë** – nënkupton një pjesëmarrës në KIPS, i cili përdor një pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, si ndërmjetësues me qëllim që të kryejë disa nga aktivitetet e lejuara në sistem;
- 1.39. **Ditë pune e sistemit** – nënkupton një ditë ose pjesë të saj gjatë së cilës pjesëmarrësit në sistem janë të hapur për pranimin, përpunimin, si dhe transferin e transaksioneve të pagesave;
- 1.40. **Netimi** – nënkupton përcaktimin e obligimeve neto të pagesave ose përcaktimin e vlerës përfundimtare neto të obligimeve të shlyerjes në mes të dy e më shumë pjesëmarrësve në sistem të pagesave;
- 1.41. **Shlyerje e udhëzimeve neto** – nënkupton shlyerjen në baza neto të transaksioneve të pagesave nga komponenti ACH sipas sesioneve të kliringut;
- 1.42. **Kliring** – nënkupton procesin e bartjes, barazimit, konfirmimit të udhëzimeve për transfer të fondeve dhe të letrave me vlerë para shlyerjes dhe përfshin netimin e urdhërpagesave dhe krijimin e pozicioneve përfundimtare për shlyerjen e tyre;
- 1.43. **Udhëzim** – nënkupton rekomandim me shkrim të lëshuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së;
- 1.44. **VPN (Virtual Private Network)** – nënkupton rrjetin vendor që përdoret ekskluzivisht nga pjesëmarrësit në sistemin KIPS;
- 1.45. **Kompjuter** – nënkupton kompjuterin nëpërmjet të cilit pjesëmarrësit monitorojnë pagesat përkatëse dhe administrojnë radhën e tyre;
- 1.46. **SRK** – nënkupton Sistemin i Regjistrimit Kontabël;
- 1.47. **Urdhër për pagesë** – nënkupton çdo udhëzim nga paguesi apo i paguari dhënë institucionit të tij ose të saj të pagesave ku kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesave.

Neni 3

Organizimi dhe rregullimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare

1. Roli i BQK-së në rregullimin e sistemit të pagesave ndërbankare - KIPS është si vijon:
 - 1.1. BQK është pronare, operon dhe mbikëqyrë sistemin e pagesave ndërbankare, si dhe është pjesëmarrëse në kliring dhe shlyerje për kryerjen e pagesave që rrjedhin nga aktiviteti i saj operativ.

- 1.2. BQK administron llogaritë e shlyerjes, ofron hua brenda-ditore për likuiditet, si dhe lehtësira për të siguruar sisteme efikase dhe të qëndrueshme të kliringut dhe pagesave.
- 1.3. Harton aktet nënligjore për të siguruar funksionimin dhe sigurinë e sistemit të pagesave.
- 1.4. Pranon pjesëmarrës të rinj në KIPS ose ndryshon informacionin e mbajtur për pjesëmarrës në KIPS.
- 1.5. Hap dhe mban llogaritë e shlyerjes, zhvillon procesin në cilësinë e agjentit shlyerës.
- 1.6. Nënshkruan marrëveshjen me pjesëmarrësit në KIPS.
- 1.7. Vendos për kufizimin e përkohshëm dhe pezullimin e qasjes të një pjesëmarrësi në sistem.
- 1.8. Siguron avancimin e KIPS në përputhje me standardet si vijojnë:
 - 1.8.1. Parimet e BIS mbi netimin dhe parimet e infrastrukturës së tregjeve financiare të Komitetit mbi Sistemin e Pagesave;
 - 1.8.2. Organizatën Ndërkombëtare për Standarde (ISO) 20022;
 - 1.8.3. Parimet dhe standardet e dala nga Banka Qendrore Evropiane në lidhje me sistemet e pagesave.

Neni 4

Administrimi dhe operimi i sistemit të pagesave ndërbankare

1. BQK mirëmban funksionimin e KIPS, duke u lejuar pjesëmarrësve qasje në sistem në përputhje me orët e punës së sistemit.
2. Përcakton plane emergjente, të cilat sigurojnë përmbushjen në kohë të proceseve ditore të sistemit, në rrethana të paparashikuara.
3. Administron sistemin duke ju mundësuar pjesëmarrësve qasje të barabartë, duke u bazuar në mekanizma të sigurt për mbrojtjen e qasjes ndaj tij, për vërtetimin e dërguesit të udhëzimit të pagesës, për mbrojtjen e besueshmërisë dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë dhe të ruajtur nga KIPS.
4. Përcakton procedurat ditore të hapjes-mbylljes, arkivimit dhe backup-it të sistemit.
5. Përcakton orët operuese në KIPS.
6. Përcakton përfshirjen e pjesëmarrësve në sistem dhe kryen procedurat e anëtarësimit dhe certifikimit të një pjesëmarrësi të ri në sistem.
7. Administron sigurinë e sistemit.
8. Monitoron sistemin e pagesave ndërbankare dhe veçanërisht:
 - 8.1. gjendjen funksionale të sistemit;
 - 8.2. shlyerjen e pagesave;
 - 8.3. ndërlidhjet e KIPS-it me sistemet e tjera;
 - 8.4. gjendjen e dërgim/pranimit të mesazheve të transaksioneve të pagesave;
 - 8.5. gjendjen e lidhjeve VPN;

- 8.6. statusin e çdo llogarie teknike dhe pozicionet neto në çdo kohë;
- 8.7. mesazhet e pagesave të importuara dhe statusin e tyre;
- 8.8. gjendjen e llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësve;
- 8.9. pagesat e kryera nga/për një llogari;
- 8.10. transaksionet e pagesave në pritje në radhën e një pjesëmarrësi.

Neni 5

Mbikëqyrja e sistemit të pagesave ndërbankare në Kosovë

1. Në kuadër të funksionit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave ndërbankare, BQK:
 - 1.1. Vlerëson dhe analizon kushtet aktuale të sistemit dhe rreziqet e lidhura me sistemin me qëllim të përmirësimit të sistemit dhe rritjes së efikasitetit, besueshmërisë, sigurisë dhe të stabilitetit të sistemit të pagesave ndërbankare.
 - 1.2. Nxjerr rregullore dhe metodologji për reduktimin e rrezikut sistemik në përputhje me parimet dhe rekomandimet për sistemet me rëndësi sistemike.
 - 1.3. Kryen kërkime në fushën e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes, me qëllim zhvillimin e sistemit.
 - 1.4. Ndërhyn për zhvillimin e KIPS-it nëpërmjet:
 - 1.4.1. bashkëpunimit me pjesëmarrësit dhe autoritete të tjera në këtë fushë;
 - 1.4.2. koordinimit të aktiviteteve të pjesëmarrësve të sistemit;
 - 1.4.3. ndryshimeve të nevojshme të sistemit që janë në përputhje me objektivat e sigurisë dhe të efikasitetit, si dhe
 - 1.4.4. administrimit të situatave të emergjencës, ku analizon shkaqet, karakteristikat teknike apo operative, si dhe efektet në sistemin e pagesave dhe atë financiar.

Neni 6

Sistemi Ndërbankar i Pagesave dhe komponentët e tij

1. KIPS është sistem i automatizuar për procesimin e transaksioneve të pagesave ndërbankare në Republikën e Kosovës.
2. KIPS siguron shlyerje në baza bruto të pagesave individuale dhe urgjente, shlyerjen e pozicioneve neto për urdhërtransferet në grumbull dhe shlyerjen e letrave me vlerë që pranohen nga Sistemi i Regjistrimit Kontabël (SRK) në BQK.
3. Sistemi qendror i KIPS-it, përfshinë:
 - 3.1. komponentin e RTGS-së-“Settlement”, për procesim të pagesave me vlera të mëdha dhe pagesave urgjente;
 - 3.2. komponentin e ACH-së-“Clearing”, për procesim të pagesave me vlera të vogla;
 - 3.3. komponentin e PO-së, për regjistrimin manual të pagesave, në rast të mos funksionimit të komponentit “Gateway” për ndërlidhje automatike të pjesëmarrësve me KIPS.

4. KIPS mundëson shkëmbimin e mesazheve të urdhërtransfereve sipas standardit ndërkombëtar ISO 20022 përmes lidhjeve të dyfishta të rrjetit VPN.
5. Shkëmbimi i mesazheve të transaksioneve të pagesave në mes pjesëmarrësve dhe KIPS-it mundësohet përmes:
 - 5.1. gateway-it, për shkëmbim automatik të mesazheve në mes KIPS-it dhe sistemit bazë të pjesëmarrësve;
 - 5.2. stacioneve punuese (kompjuter), për ndërlidhje në KIPS të pjesëmarrësve përmes ueb shfletuesit.

Neni 7

Informacioni nga Sistemi i Pagesave Ndërbankare

1. KIPS siguron informacion në kohë reale për pjesëmarrësit në lidhje me:
 - 1.1. pozitën e likuiditetit në BQK;
 - 1.2. vlerën dhe vëllimin e transaksioneve të pagesave individuale dhe në grup të shlyera për çdo pjesëmarrës;
 - 1.3. listën me transaksionet e pagesave individuale dhe në grup në pritje për t'u ekzekutuar;
 - 1.4. fondet e mjaftueshme për llogarinë e shlyerjes;
 - 1.5. përmbajtjen e file-ve të transaksioneve të pagesave individuale dhe në grup;
 - 1.6. pozicionet neto për shlyerje të pagesave nga ACH;
 - 1.7. përdoruesit e regjistruar në KIPS dhe aktivitetet e tyre;
 - 1.8. orarin e operimit në KIPS dhe sesionet e kliringut.
2. Secili pjesëmarrës është përgjegjës për monitorimin e shlyerjeve të pagesave që i ka dërguar gjatë ditës, si dhe BQK nuk do të jetë përgjegjës për humbjet e shkaktuara për shkak të pakujdesisë së pjesëmarrësve për monitorim dhe menaxhim të transaksioneve në pritje apo të refuzuara.

Neni 8

Shlyerja dhe ekzekutimi i transaksioneve të pagesave nëpërmjet RTGS-së

1. Nëpërmjet komponentës së RTGS-së, ekzekutohet shlyerja në EURO dhe me vlerë të pakufizuar e:
 - 1.1. transaksioneve të pagesave për dhe nga llogaritë e klientëve të pjesëmarrësve në sistem;
 - 1.2. transaksioneve ndërmjet pjesëmarrësve, që nënkupton transaksionin e urdhëruar drejtpërdrejt për pjesëmarrësin tjetër;
 - 1.3. transaksioneve neto të kliringut nga komponenti ACH;
 - 1.4. transaksioneve të letrave me vlerë dhe ato për mbështetje ditore të likuiditetit (ILF);
 - 1.5. kërkesave për shlyerje nga sisteme të tjera pagesash;
 - 1.6. transaksioneve të pagesave për tërheqje të parave të gatshme;

- 1.7. transaksioneve të pagesave ndërkombëtare të iniciuara nga bankat prej llogarive të tyre në BQK;
- 1.8. transaksioneve të pagesave që lidhen me interesat dhe me tarifat e aplikuara nga BQK.
2. Shlyerja e një transaksioni pagese kryhet menjëherë pasi ka marrë statusin “i regjistruar” në sistemin KIPS.
 3. Një transaksion pagese konsiderohet që ka marrë statusin “i regjistruar”, kur të ketë kaluar të gjithë hapat e validimit të vlefshmërisë teknike, e të rezultojë i vlefshëm për t’u shlyer, si dhe të ketë bilanc të mjaftueshme në llogarinë përkatëse të shlyerjes së pjesëmarrësit urdhërues. Në momentin që ka marrë statusin “i regjistruar”, transaksioni i pagesës konsiderohet i parevokueshëm.
 4. Shlyerja e një transaksioni kryhet menjëherë pas momentit të regjistrimit të tij në KIPS, në rast se pjesëmarrësit sigurojnë një sasi të mjaftueshme fondesh për të mbuluar shlyerjen. Nëse pjesëmarrësi urdhërues nuk ka mjete të mjaftueshme në llogarinë e shlyerjes, transaksioni i pagesës do të vendoset në listën e pritjes.
 5. Procedurat për shlyerjen e pagesave në pritje, për pjesëmarrësit apo operatorë që janë në proces të falimentimit, janë të rregulluara në nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave.
 6. Tërheqja e transaksioneve të pagesave nuk mund të bëhet pas ekzekutimit të shlyerjes së saj dhe dërgimit të mesazhit tek pala pranues. Në këtë rast vetëm mund të bëhet kërkesa për kthim nga pranuesi.
 7. Për çdo transaksion të dërguar në RTGS nga pjesëmarrësit, KIPS do të bëjë validimin dhe do të njoftoj pjesëmarrësin për pranimin apo refuzimin e tij.
 8. Transaksionet e pranuar nga KIPS ekzekutohen në datën e vlefshmërisë.
 9. KIPS pranon transaksionet e pagesave me datë vlefshmërisë të ardhme deri në pesë (5) ditë pune nga data e dërgimit të transaksionit.
 10. Transaksionet e pagesës me datë vlefshmërisë të njëjtë me datën e ditës së punës në të cilën janë dërguar dhe pranuar nga KIPS, ekzekutohen po atë ditë.
 11. Transaksionet e tjera të pagesës të pranuar nga KIPS, ruhen derisa dita e punës së KIPS-së të përputhet me datën e vlefshmërisë e përcaktuar nga pjesëmarrësi.
 12. Nëse data e vlefshmërisë nuk i përket një dite pune në KIPS, ky i fundit refuzon transaksionet e pagesave të pranuar për atë ditë.
 13. Banka urdhëruese, e ekzekuton një transaksion pagese RTGS në KIPS, brenda 15 minutave pasi që ai transaksion është iniciuar nga paguesi, me përjashtim të pagesave të cilat në bazë të procedurave përkatëse kërkojnë kontrolla dhe autorizime specifike, ekzekutimi i të cilave mund të vonohet, por jo më shumë se 60 minuta.

Neni 9

Ekzekutimi i pagesave nëpërmjet ACH- së

1. Nëpërmjet komponentit të ACH-së, ekzekutohet kliringu vetëm i transaksioneve të pagesave në grup, si vijon:

- 1.1. që kanë vlerë deri në 10,000.00 Euro. Ky kufi nuk vlen për tipin e pagesave masive (pagesat me UNIREF) dhe për Kos Giro;
- 1.2. të nënshkruar në mënyrë digjitale dhe të formatuar në përputhje me formatin ISO20022.
2. Pjesëmarrësit dërgojnë transaksionet e pagesës në sistemin ACH në formë të mesazheve të grupuara sipas standardit ISO 20022.
3. Sistemi ACH proceson pagesat në grup dhe përbërja e një grupi të transaksioneve të pagesave mund të jetë:
 - 3.1. transaksion i pagesës me vlerë të vogël (transfer krediti, e nisur nga një bankë urdhëruese);
 - 3.2. debitim direkt (transfer debiti, e nisur nga një bankë përfituese);
 - 3.3. refuzim debitimesh direkte.
4. Të gjitha transaksionet e pagesave së një grupi kanë të njëjtën datë të vlefshmërisë dhe të njëjtin tip pagese.
5. Pjesëmarrësi siguron fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij të shlyerjes, në mënyrë që transaksioni i shlyerjes neto i gjeneruar nga ACH të shlyhet menjëherë, në fund të çdo sesioni të kliringut. Grupi i transaksioneve të pagesave, i shlyer gjatë një sesioni të kliringut nuk mund të tërhiqet (anulohet).

Neni 10

Barazimi, qasja në të dhëna dhe raportimi

1. KIPS i ruan log file në afat kohor prej 12 muaj.
2. Në bazën e të dhënave operacionale të KIPS, pjesëmarrësit kanë qasje vetëm për të dhënat me vjetërsi nga një (1) deri dy (2) vjet. Në çdo fund të një viti kalendarik, nga baza operacionale e KIPS-it do largohen të dhënat e vitit paraprak.
3. BQK me kërkesë të pjesëmarrësit brenda pesë (5) ditëve pune nga dita e parashtrimit të kërkesës, përgatitë një raport informues për të dhënat e kërkuara për periudhën më të hershme se afati i lartpërmendur.
4. KIPS prodhon raporte përmbledhëse për barazim, në fund të çdo dite pune.
5. KIPS ofron raporte operacionale gjatë gjithë ditës së punës, të cilat mund të përdoren për qëllime kontrolli nga BQK dhe pjesëmarrësit e tjerë.
6. Përmbajtja e raporteve dhe mënyra e përdorimit të tyre përshkruhen në manualin e përdoruesit të sistemit, ofruar nga prodhuesi i KIPS-it.
7. BQK nxjerrë raporte përmbledhëse në mënyrë automatike nga baza e të dhënave në KIPS në çfarëdo kohe dhe për këtë qëllim, ajo ka qasje në të gjitha të dhënat për pjesëmarrësit.

Neni 11

Pjesëmarrësit në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Pjesëmarrësit në kliring dhe shlyerje në KIPS janë:
 - 1.1. BQK;

- 1.2. Bankat komerciale;
 - 1.3. Thesari - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.4. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës;
 - 1.5. Operator të sistemeve të pagesave të licencuar nga BQK;
 - 1.6. Institucionet Financiare Jobankare të autorizuara nga BQK për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe emetimin e parave elektronike (institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike);
 - 1.7. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.
2. Pjesëmarrja e subjekteve të referuar në nënparagrafët 1.6 dhe 1.7 të këtij neni është subjekt i aprovimit të BQK bazuar në legjislacionin e aplikueshëm.

Neni 12

Anëtarësimi në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Pjesëmarrësit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për anëtarësim në KIPS:
 - 1.1. të kenë hartuar rregulla të brendshme operimi për pjesëmarrje në KIPS;
 - 1.2. të kenë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në KIPS;
 - 1.3. të kenë kryer të gjitha përgatitjet teknike për komunikim me sistemin e KIPS-it, të parapara me rregullat e BQK-së dhe dokumentacionin tek të KIPS-it;
 - 1.4. të jenë pajisur me BIC të lëshuar nga SWIFT;
 - 1.5. të kenë të hapur një llogari bankare në BQK;
 - 1.6. të kenë nënshkruar Letërpëlqimin për pjesëmarrje në KIPS, shtojca 1 e kësaj rregulloreje;
 - 1.7. të marrin pjesë në KIPS vetëm nëpërmjet zyrave qendrore dhe qendrave të vazhdimësisë së bizneseve.

Neni 13

Procedura për anëtarësim në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Institucioni paraqet një kërkesë me shkrim për anëtarësimin e tij në KIPS, pranë BQK-së.
2. BQK shqyrton kërkesën e institucionit brenda 30 ditëve të punës pas plotësimit të dokumentacionit sipas kërkesave të BQK-së.
3. Në rast të miratimit të kërkesës, BQK brenda një (1) jave nga dita e miratimit, informon institucionin për përmbajtjen e kësaj rregullore, si dhe për minimumin e kërkesave teknike që ai duhet të përmbushë sipas udhëzimeve dhe standardeve të KIPS-it.
4. BQK në bashkëpunim me institucionin, përcaktojnë dhe zbatojnë procedurat e anëtarësimit.
5. BQK trajnon dhe organizon testimet për përdoruesit e institucionit.
6. Institucioni për pjesëmarrje plotëson aplikacionin përkatës dhe e nënshkruan Letërpëlqimin e pjesëmarrjes në KIPS.

7. BQK kryen veprimet e saj për regjistrimin e pjesëmarrësit në KIPS, si dhe krijimin e përdoruesve dhe dorëzimin e pajisjeve të sigurisë (e-token) për pjesëmarrësin.
8. BQK do t'i njoftojë të gjithë pjesëmarrësit në KIPS për emrin, adresën e saktë (kodin BIC) të pjesëmarrësit të ri, si dhe për datën në të cilën pjesëmarrësit në fjalë do t'i jepet qasje në KIPS, dhjetë (10) ditë pune para fillimit të aktivitetit.
9. BQK siguron lidhjen me VPN dhe pajisjet e nevojshme.
10. Secili pjesëmarrës në rast të bashkimit, ndarjes, ndryshimit të emrit ose në rast të ndonjë ndryshimi tjetër në informacionet e kërkuara në Letërpëlqim, do të njoftojë menjëherë dhe do t'i ofroj BQK-së informacionet e kërkuara për ndryshimin.

Neni 14

Kufizimi i përkohshëm në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. BQK duhet të kufizojë përkohësisht një pjesëmarrës në KIPS, në rastet kur verifikohet paaftësi e pjesëmarrësit për ekzekutimin e një kërkesë për shlyerje.
2. Pas vendosjes së kufizimit për pjesëmarrësin, i njëjti mund të qaset në sistem, por nuk mund të shlyejë pagesa nga/për pjesëmarrësit e tjerë.
3. BQK vendos për heqjen e kufizimeve të vendosura atëherë kur pjesëmarrësi siguron në llogarinë e tij të shlyerjes, fonde të mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve në KIPS.
4. BQK njofton pjesëmarrësit menjëherë për heqjen e kufizimeve me anë të shkresës zyrtare.

Neni 15

Pezullimi i qasjes të pjesëmarrësit në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. BQK duhet të pezullojë qasjen e një pjesëmarrësi në KIPS, në rast se:
 - 1.1. pjesëmarrësi nuk siguron fondet e mjaftueshme deri në ditën vijuese të ditës në të cilën ka marrë njoftimin për kufizimin e përkohshëm të qasjes së tij në KIPS sipas nenit 14 të kësaj rregullore;
 - 1.2. vëren se qasja e mëtejme në sistem nga pjesëmarrësi mund të përbëjë kërcënim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar;
 - 1.3. pjesëmarrësi nuk është në përputhje me një kërkesë për pjesëmarrje apo shkel detyrimet e përcaktuar në këtë rregullore;
2. BQK njofton për vendimin e pezullimit të qasjes të një pjesëmarrësi në KIPS me shkresë zyrtare pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të KIPS-it.
3. Pjesëmarrësi, të cilit i pezullohet qasja në KIPS sipas këtij neni, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në KIPS, por ende ka të drejtë që t'i qaset të dhënave të tij/saj jashtë sistemit me anë të një kërkesë në BQK.
4. Pezullimi i një pjesëmarrësi do të shkaktoj ngrirjen e menjëhershme të llogarisë së tij të pagesave apo çfarëdo llogarie për shlyerje të cilat janë nën kontrollin e tij/saj.

5. Pjesëmarrësi mund të kërkojë pezullimin, kur, për shkak të çështjeve të përkohshme teknike ose operacionale, beson se është përkohësisht i paaftë për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj rregullore.
6. BQK-ja nuk do të ketë asnjë detyrim për asnjë pjesëmarrës për ndonjë humbje, dëmtim, kosto, shpenzim, përgjegjësi apo pretendim në lidhje me pezullimin e një pjesëmarrësi.
7. BQK vendos për heqjen e pezullimit atëherë kur pjesëmarrësi siguron në llogarinë e tij të shlyerjes, fonde të mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tij në KIPS, apo plotëson kushtet që kanë sjellë pezullimin e pjesëmarrjes.
8. BQK njofton pjesëmarrësit menjëherë për heqjen e pezullimit.

Neni 16

Përrjashtimi i pjesëmarrësve nga Sistemi i Pagesave Ndërbankare

1. BQK vendos për përjashtimin e një pjesëmarrësi nga sistemi KIPS, në rastet e paraqitura si më poshtë:
 - 1.1. me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit dhe pas miratimit të saj nga BQK;
 - 1.2. pjesëmarrësi bashkohet me një apo disa banka;
 - 1.3. pjesëmarrësi të cilit i është pezulluar qasja në KIPS, nuk siguron fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij të shlyerjes brenda ditës pasardhëse nga data e pezullimit;
 - 1.4. pjesëmarrësi nuk i respekton dispozitat e kësaj rregullore;
 - 1.5. pjesëmarrësi vendoset në proces likuidimi dhe i revokohet licenca nga BQK;
 - 1.6. pjesëmarrësi nuk shfrytëzon sistemin KIPS-it për dërgim ose pranim të transaksioneve të pagesave brenda dymbëdhjetë (12) muajve.
2. BQK njofton pjesëmarrësin me anë të shkresës zyrtare lidhur me vendimin e përjashtimit të tij nga KIPS.
3. BQK mbyll llogarinë e pjesëmarrësit të përjashtuar.

Neni 17

Detyrimet e pjesëmarrësve në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Të zbatojnë rregullat dhe procedurat e KIPS-it.
2. Të qasen në KIPS në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret e tij të punës.
3. Të administrojnë sistemet e tyre lokale për të siguruar vazhdimësinë dhe dërgimin e transaksioneve të pagesave në KIPS.
4. Të mos lejojnë personelin e përkohshëm apo të jashtëm të operojë në KIPS.
5. Të njoftojnë menjëherë në BQK në rast të lëvizjes së personelit për anulimin e certifikatës së përdoruesit që ka operuar në KIPS.
6. Të hartojnë procedura të brendshme për sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet kompjuterike), në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.

7. Të raportojnë menjëherë në BQK për parregullsi të vërejtur apo të dyshuar të sigurisë në KIPS.
8. Të kanalizojnë pagesat në KIPS, vetëm mbi bazën e një dokumenti të vlefshëm justifikues apo fakteve elektronike.
9. Të sigurojnë integritetin e transaksioneve të pagesave dhe qasjeve të përdoruesve brenda institucioneve përkatëse:
 - 9.1. duke caktuar lokacionin për qasje primare dhe sekondare (backup) në KIPS, vetëm aty ku ka kushte të përshtatshme për mjete digjitale dhe të telekomunikimit, si dhe të ekzistojë siguria që funksionimi i KIPS-it nuk do të jetë subjekt i ndërprerjeve apo i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorët e brendshëm apo të jashtëm;
 - 9.2. duke zbatuar parimin “*katër sytë*” për autorizimin e transaksionit të pagesës, duke siguruar përdorues të ndryshëm për përfshirjen e të dhënave dhe aprovimin e tyre;
 - 9.3. duke kryer procedura identifikuese në çdo hallkë të komunikimit midis sistemeve të brendshëm të tyre dhe KIPS-it;
 - 9.4. duke u bërë subjekt kontrolli nga personeli mbikëqyrës për çdo pagesë të refuzuar, të korrigjuar apo të fshirë;
 - 9.5. duke u regjistruar të gjitha komunikimet elektronike që lidhen me transaksionet e pagesave, duke shënuar kohën e transmetimit.
10. Të ruajnë regjistrimet e transaksioneve të pagesave në kopje letër apo format elektronike për një periudhë jo më pak se pesë (5) vite, sipas standardeve dhe rregullave kontabël në fuqi në BQK.
11. Të hartojnë një plan emergjence, i cili garanton përmbushjen në kohë të veprimeve ditore në KIPS në rrethana të paparashikuara.
12. Të kryejnë vlerësime periodike të integritetit dhe të qëndrueshmërisë së pajisjeve të tyre të brendshme që lidhen me KIPS.

Neni 18

Qasja e pjesëmarrësve në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Për qasje dhe komunikim me KIPS, pjesëmarrësit duhet të përgatiten me infrastrukturën harduerike dhe softuerike. Përveç komponenteve softuerike, ‘Gateway-it’ dhe certifikatës digjitale, BQK nuk ka obligim të mbështes pjesëmarrësit në infrastrukturë tjetër teknike.
2. Çdo pjesëmarrës zotëron një ose më shumë ‘kompjuter’ për komunikim on-line në KIPS, dhe mbanë përgjegjësi për funksionimin e tyre.
3. Nga ‘kompjuterët’ e tyre, përdoruesit e pjesëmarrësve do të qasen në ueb aplikacionin e sistemit të KIPS-it dhe kryejnë funksionet që ofron ky sistem.
4. Aplikacioni i KIPS-it është i qasshëm për pjesëmarrës vetëm nëse paraprakisht përdoruesit e tyre janë të pajisur me e-token në të cilën gjendet certifikata valide e lëshuar nga BQK.
5. BQK, çdo vit ripërtërin certifikatën në e-token të përdoruesve të sistemit të pjesëmarrësve. Në rast të largimit të një përdoruesi, pjesëmarrësi duhet të njoftojë BQK-në për anulim të certifikatës ekzistuese.

6. Për çdo pjesëmarrës, BQK do të regjistrojë nga dy përdorues me të drejtë administrimi, pastaj këta përdorues mund të regjistrojnë përdoruesit tjerë të atij pjesëmarrësi. Me kërkesë të pjesëmarrëseve, BQK mund të ofroj mbështetjen për regjistrimin në KIPS edhe të përdoruesve tjerë, si; regjistrimin/mbylljen e përdoruesve, resetimin e fjalëkalimit, lëshimin e token-ve me certifikata digjitale, etj.
7. Për të kërkuar mbështetje për regjistrimin/mbylljen e përdoruesit, marrjen/dorëzimin e token-it, re-instalimin/marrjen e certifikatës, pjesëmarrësit e dërgojnë në BQK “Aplikacionin për përdorues dhe token”, *shtojca 2* e kësaj rregullore.
8. Çdo kërkesë për mbështetje nga BQK lidhur me përdoruesit, duhet të jetë e nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i institucionit përkatës dhe duhet të dërgohet në BQK me e-mail zyrtar, e skanuar paraprakisht ose/edhe kopje fizike.
9. Përgjigjja lidhur me kërkesën për përdorues, nga BQK do të kthehet tek pjesëmarrësi më se largu deri në fund të ditës tjetër të punës.
10. BQK për çdo institucion pjesëmarrës do të ofrojë një fjalëkalim të paracaktuar (eng. default) i cili do të përdoret për qasje në KIPS për herën e parë pas hapjes së përdoruesit apo pas kërkesës për ndërrim të fjalëkalimit.
11. Kërkesa për ndërrim të fjalëkalimit duhet të dërgohet në BQK me e-mail zyrtar nga personi i kontaktit të institucionit pjesëmarrës.

Neni 19

Informacioni i nevojshëm në mesazhet ISO 20022

1. Në të gjitha rastet, mesazhet e transaksioneve të pagesave që dërgohen në KIPS së paku duhet të përmbajnë:
 - 1.1. përcaktimin e informatave për identifikim të debitorit dhe kreditorit;
 - 1.2. referencën e transaksionit të pagesës;
 - 1.3. data vlefshmërisë së pagesës;
 - 1.4. përshkrimin e transaksionit të pagesës;
 - 1.5. shumën e shprehur në EURO.
2. Për çdo transaksion, kombinimi i numrit të referencës së bashku me shumën e pagesës dhe datën e vlefshmërisë duhet të janë unike për çdo bankë urdhëruese brenda ditës së punës.
3. Nëse data e vlefshmërisë nuk i përket një dite pune të KIPS-it, ky i fundit refuzon transaksionet e pagesave të pranuar për atë ditë.

Neni 20

Ditët dhe orët e punës në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. KIPS do të operoj çdo ditë nga e hëna deri në të premten, përveç festave zyrtare të përcaktuara në Ligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës dhe vendimeve nga BQK.

2. Orari i operimit dhe sesionet e kliringut në KIPS, rregullohen nga BQK dhe i njëjti vendoset/publikohet në aplikacionin e këtij sistemi (ku të gjithë pjesëmarrësit mund ta shohin në çdo kohë) dhe në ueb faqen e BQK-së.
3. BQK mund të zgjat apo reduktojë orët e punës në KIPS në situata të paparashikuara dhe emergjente, në raste të caktuara për transfer të pagesave të nevojshme për likuiditet të pjesëmarrësve, në rastet e problemeve teknike të cilat mund të kenë ndikuar në procedurat operuese, dhe në rast të kërkesave të veçanta të rëndësisë shtetërore.
4. Pjesëmarrësit njoftohen për çdo ndryshim të orarit me e-mail zyrtar apo mesazhin Camt.998.

Neni 21

Kontrolli për mjaftueshmërinë e fondeve

1. Transaksion i pagesës ekzekutohet vetëm në rast se ka fonde të mjaftueshme në llogarinë e pjesëmarrësit që debitohet.
2. Mjaftueshmëria e fondeve në llogarinë e pjesëmarrësit përcaktohet nga gjendja e llogarisë si dhe nga minimumi i rezervës së detyruar.
3. Pjesëmarrësit monitorojnë gjendjen e llogarisë përkatëse dhe marrin masa për sigurimin e likuiditeteve të nevojshme për shlyerjen e transaksioneve të pagesave.
4. Llogaritë e dy pjesëmarrësve të përfshirë në pagesë debitohen dhe kreditohen respektivisht, duke gjeneruar mesazhet konfirmuese, sipas formatit përkatës të KIPS-it.
5. Në rastet e procedurave për paaftësi paguese të pjesëmarrësve, çështjet që lidhen me finalizimin e shlyerjes rregullohen në pajtim me rregullativën përkatëse të BQK-së.

Neni 22

Radha e pagesave në pritje

1. Pagesat të cilat nuk mund të ekzekutohen për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit, vendosen nga KIPS në radhë pritjeje dhe rikontrollohen nga sistemi sa herë që të dhënat mbi fondet në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit, ndryshojnë.
2. Radhitja e pagesave dhe kontrolli për mjaftueshmërinë e fondeve, kryhet mbi bazën e prioritetit/përparësisë të dhënë transaksioneve të pagesave nga pjesëmarrësit, si dhe kohën e arritje (sipas metodës FIFO).
3. Ndryshimi i kësaj radhitje mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 24 të kësaj rregullore.
4. Secili lloj i transaksioneve të pagesave e ka brezin e kodeve të prioritetit brenda të cilit pjesëmarrësit duhet ta vendosin një kod.

Neni 23

Nivelet e përparësisë

1. Çdo pagese i jepet një nga nivelet e mëposhtme të përparësisë:
 - 1.1. niveli i parë i jepet shlyerjes së transaksioneve neto të kliringut nga ACH;

- 1.2. niveli i dytë i jepet pagesave të iniciuara nga BQK;
- 1.3. niveli i tretë i jepet pagesave ndërmjet pjesëmarrësve;
- 1.4. niveli i katërt i jepet pagesave prioritare për llogaritë e klientëve të pjesëmarrësve.

Neni 24

Ri-klasifikimi i pagesave në radhë

1. Me përjashtim të udhëzimeve për shlyerje neto, kthimin e kredive brenda ditore dhe pagesat e iniciuara nga BQK, çdo pjesëmarrës mund të bëjë riklasifikimin e pagesave të veta, duke ndryshuar renditjen e pagesave në radhë.
2. Çdo pjesëmarrës mund të ndryshojë renditjen e pagesave të veta, të cilat janë ende të pashlyera në radhë, brenda të njëjtës përparësi. Renditja bëhet duke ndërruar kodin e prioritetit brenda brezit të kodeve për atë lloj të transaksioneve.
3. Riklasifikimi i pagesave në radhë mund të kryhet, gjithashtu nga BQK kur pjesëmarrësi ka kërkuar riklasifikim.

Neni 25

Anulimi i një pagese në radhë

1. Gjatë ditës së punës BQK mund të anulohet një pagesë në radhë për sa kohë që pagesa nuk është shlyer:
 - 1.1. me kërkesë të specifikuar të pjesëmarrësit;
 - 1.2. kur BQK vlerëson se pjesëmarrësi për shkak të problemeve teknike, nuk mund ta administrojë radhën përkatëse.
2. Gjatë mbylljes së ditës, nëse ka pagesa të pashlyera në radhën e një pjesëmarrësi, ato anulohen automatikisht nga KIPS dhe pjesëmarrësi informohet me mesazh përkatës ISO 20022.

Neni 26

Administrimi i pagesave në grup

1. Pjesëmarrësit krijojnë/regjistrojnë ose importojnë nga sistemet e tyre të brendshme disa lloje të transaksioneve të pagesave në ACH, të cilat më pas grupohen nga sistemi, të ndara për çdo bankë përfituese.
2. Në komponentin ACH procesohen kredit transferet dhe transferet e debitit. Kredit transferet janë të ndara në transaksione: normale, giro, massive, paga/pensione, dhe të kthyera.
3. Pjesëmarrësit kujdesen që çdo grup i transaksioneve të pagesave të ketë një numër unik reference.
4. Çdo transaksion i pagesës në grup i refuzuar nga ACH, mund të ridërgohet në sistem pas korrigjimit të tij nga pjesëmarrësi përkatës. Grupi i ridërguar duhet të ketë një numër të ri të referencës.
5. Sistemi ACH përpunon grupet e transaksioneve të pagesave me vlerë të vogël sipas radhës në të cilën janë dërguar (sipas metodës FIFO).

6. Grupet e transaksioneve të pagesave që transmetohen tek banka përfituese pas shlyerjes së pozicioneve neto në RTGS, në fund të sesionit të kliringut në sistemin ACH, kanë nënshkrimin digjital të urdhëruesit të transaksionit të pagesës.
7. Grupet me transaksionet e pagesave të debitimit direkt realizohen në sesionin e fundit të kliringut të datë së vlefshmërisë.

Neni 27

Vërtetimi i pagesave në grup

1. Transaksionet e pagesave në grup që dështojnë në procesin e validimit refuzohen nga KIPS.
2. KIPS njofton pjesëmarrësin për grupet e transaksioneve të pagesave të pranuar apo të refuzuara nëpërmjet file-ve të dërguar në sistem. Mesazhi i refuzimit përmban numrin e referencës së grupit të refuzuar, arsyet e refuzimit dhe kodin e gabimit përkatës.
3. KIPS vërteton transaksionet e pagesave në grup sipas kritereve të mëposhtme:
 - 3.1. të gjitha grupet, duhet të kenë nënshkrimin digjital;
 - 3.2. kodet BIC për pjesëmarrësit duhet të jenë në listën e pjesëmarrësve;
 - 3.3. të gjitha transaksionet e pagesave brenda një grupi duhet të kenë të njëjtën datë të vlefshmërisë, të njëjtin tip të transaksioneve dhe të njëjtin pjesëmarrës urdhërues/debitor;
 - 3.4. asnjë transaksion i pagesës me vlerë të vogël të dërguar si normale nuk duhet të ketë vlerë më të madhe se kufiri i sipërm i vendosur nga BQK;
 - 3.5. grupet me transaksionet e pagesave me vlerë të vogël dërgohen brenda orareve të caktuara të operimit në KIPS;
 - 3.6. numri i referencës së një grupi të transaksioneve të pagesave duhet të jetë unik.

Neni 28

Procedurat e operimit për sesionet e kliringut

1. Gjatë një dite pune, në komponentin ACH zhvillohen tri ose më shumë sesione kliringu.
2. Sistemi ACH për pjesëmarrësit gjeneron informacionet e mëposhtme:
 - 2.1. raportet e ditëve paraprake;
 - 2.2. fillimin e sesionit të kliringut;
 - 2.3. fillimin e pranimin të file-ve;
 - 2.4. fundin e pranimin të file-ve;
 - 2.5. dërgimin e shlyerjes neto në KIPS;
 - 2.6. përfundimin e sesionit;
 - 2.7. ndryshimet e bëra në prerjen përfundimtare, në orarin e ditës së punës, në kalendar, modifikimin e statusit të një pjesëmarrësi në sistem;
 - 2.8. raportet e fundit të ditës;

- 2.9. raportet që gjenerohen në shlyerje;
- 2.10. raportin e faturimit ditor dhe mujor.
3. Refuzohen automatikisht nga sistemi ACH grupet me transaksione debitimesh direkte dhe refuzime debitimesh direkte, të cilët nuk janë aprovuar deri para kryerjes së prerjes përfundimtare.
 4. Transaksionet e pagesave në grup, me madhësi mbi 10 mijë transaksione të pagesave, duhet të dërgohen nga cilido pjesëmarrës më së largu tridhjetë (30) minuta para mbylljes së sesionit të fundit të kliringut.
 5. Transaksionet e pagesave që nuk procesohen në një sesion kliringu transferohen në sesionin tjetër, ndërsa transaksionet që nuk procesohen në sesionin e fundit të kliringut refuzohen.

Neni 29

Procedurat për transaksionet e debitimit direkt

1. Transferi i debitimit direkt që realizohet përmes KIPS-it, është një transfer i debitit tek i cili urdhëruesi (inicuesi) është i paguari, bankë e urdhëruesit (iniciuese) është banka e të paguarit, bankë pranuese është banka e paguesit dhe pranues i transferit të debitimit direkt është paguesi.
2. Në KIPS procesohen disa lloje të transaksioneve që lidhen me debitimin direkt, si; kërkesa e debitimit direkt, refuzimi i transaksionit të debitimit direkt, kërkesa për kthim të debitimit direkt dhe autorizimi i debitimit direkt.
3. KIPS pranon transaksionet e debitimit direkt në çdo kohë nga hapja ditës për punë (Open for Business) deri në mbylljen fillestare (Initial cut-off). Pas pranimit të këtyre transaksioneve KIPS do t'i grupojë dhe dërgojë ato tek banka e paguesit.
4. Transaksionet e kërkesave për debitim direkt duhet të dërgohen së paku dy (2) ditë pune para datës së shlyerjes.
5. Ekzekutimi i transaksioneve të debitimit direkt kryhet në sesionin e tretë (3) të kliringut të datës së shlyerjes.
6. Refuzimi i transaksioneve të debitimit direkt pranohet nga KIPS vetëm nëse dërgohen para hapjes së sesionit të tretë (3) në ditën e shlyerjes dhe deri sa transaksionet që refuzohen e kanë statusin në pritje.
7. Për shlyerjen e transaksioneve të debitimit direkt në llogarinë pjesëmarrëseve, së bashku me të gjitha transaksione ACH të atij sesioni, KIPS krijon një transaksion neto të kliringut.
8. Për çdo lloj të transaksioneve të debitimit direkt, KIPS përdor lloje të ndryshme të ISO 20022 mesazheve të cilat janë të sqaruara në dokumentacionin teknik në KIPS.

Neni 30

Zgjidhja e situatës së 'Gridlock'-ut

1. BQK ndërhyr me qëllim të zgjidhjes së situatës Gridlock nëpërmjet mekanizmit të 'Gridlock'-ut.
2. KIPS aplikon mekanizmin e Gridlock-ut për të zgjedhur pagesat, shlyerja e të cilave është e mundur mbi bazën e kliringut dy apo shumëpalësh. Kjo ndërhyrje realizohet vetëm në kushtet e ruajtjes së radhitjes FIFO të transaksioneve të pagesave.

3. KIPS aktivizon në mënyrë automatike mekanizmin e Gridlock-ut, në intervale të paracaktuara kohore.
4. BQK mund të aktivizojë manualisht mekanizmin e Gridlock, në rastet kur e vlerëson të nevojshme.

Neni 31

Pagesat e refuzuara gjatë ditës

1. Refuzohen në mënyrë automatike nga sistemi KIPS:
 - 1.1. transaksionet e pagesave për llogari të klientëve të pjesëmarrësve, të cilat hyjnë në këtë sistem pas përfundimit të orarit për këtë lloj të pagesave;
 - 1.2. transaksionet e pagesave ndërmjet pjesëmarrësve, të cilat hyjnë në sistem pas përfundimit të orarit për pagesa.

Neni 32

Shlyerjet e transaksioneve neto të kliringut

1. Urdhri për shlyerjet neto të transaksioneve të pagesave që ekzekutohen në KIPS rrjedhin nga rezultati i kliringut të komponentit ACH.
2. Në çdo sesion kliringu në ACH, KIPS krijon për çdo pjesëmarrës një transaksion neto për shlyerjen e të gjitha transaksioneve të dërguara dhe pranuar për atë sesion.
3. Shlyerja e transaksioneve neto realizohet vetëm në rast se të gjithë pjesëmarrësit me pozicione neto debitorë, kanë fonde të mjaftueshme në llogaritë e tyre të shlyerjes.
4. Pjesëmarrësit duhet të kenë masa për sigurimin e fondeve të mjaftueshme në llogaritë e tyre përkatëse të shlyerjes, për shlyerjen e menjëhershme të detyrimeve të tyre neto.
5. Në raste të pamundësisë për shlyerje të transaksioneve neto të kliringut për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve, pjesëmarrësit mund të shfrytëzojnë transaksionet për mbështetje ditore të likuiditetit.
6. Transaksionet neto nga komponenti i ACH-së për një sesion kliringu janë përfundimtare dhe regjistrimi apo pagesa nuk do të kthehet, ri-paguhet apo mënjanohet.

Neni 33

Banka Qendrore e Kosovës si pjesëmarrëse në Sistemin Pagesave Ndërbankare

1. BQK kryen transaksionet e pagesave si në vijim:
 - 1.1. transaksionet e pagesave që lidhen me pasqyrimin e emetimit dhe maturimit të letrave me vlerë në KIPS;
 - 1.2. tërheqjet dhe depozitimet në para të gatshme për veprimet e iniciuara nga BQK-ja, si dhe pagesat e tyre që rrjedhin nga veprimtaria operacionale;
 - 1.3. pagesat e interesave dhe të gjobave të aplikueshme sipas dispozitave të nxjerra nga BQK;
 - 1.4. pagesat nga MF/Thesari dhe klientët tjerë të BQK-së;

1.5. pagesat e BQK-së si pjesëmarrëse në sistemin KIPS, të cilat burojnë nga veprimtaria e saj operative.

Neni 34

Validimi dhe kthimi i transaksioneve të pranuara

1. Për pagesat e procesuara përmes modulit ACH, përfshirë pagesat e pagave dhe skemave tjera sociale të urdhëruara nga institucionet qeveritare, banka pranuese do të bëjë kreditimin e përfituesit duke u bazuar vetëm në numrin e llogarisë së përfituesit, gjithmonë duke respektuar kornizën ligjore në fuqi për pajtueshmëri me kërkesat për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe kundër Financimit të Terrorizmit.
2. Një bankë përfituese është subjekt i një procedure për kthim të transaksionit të pranuar nga një bankë urdhëruese. Nëse banka përfituese nuk është në gjendje të transferojë fondet në llogarinë e përfituesit, ajo kthen transaksionet e pagesave tek banka urdhëruese, brenda ditës pasardhëse të punës.
3. Gjatë kthimit të transaksionit të gabuar, banka përfituese duhet të përfshijë elementet për identifikim të transaksionit të pagesës që ka pranuar, si dhe të përshkruajë arsyen e kthimit.

Neni 35

Llogaritë në Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Secila bankë e licencuar, bilancin e saj në KIPS e mbanë në dy nën llogari; llogaria e shlyerjes dhe llogaria e rezervës së obliguar. Fondet mund të zhvendosen nga llogaria e shlyerjes tek llogaria e rezervës dhe anasjelltas.
2. Llogaria e shlyerjes paraqet bilancin e fondeve që një pjesëmarrës mbanë në librin kryesor në BQK pa shumat e mbajtura në llogaritë rezervë, dhe ky bilanc është shuma e fondeve në dispozicion për qëllime të përgjithshme të shlyerjes.
3. Llogaria e shlyerjes do të përdoret për operacionet në KIPS dhe kjo llogari nuk mund të kalojnë në bilanc negativ.
4. Çdo lëvizje ose përmirësim në bilancin e llogarisë rrjedhëse bankare në librin kryesor të kontabilitetit në BQK, që ndodh pas përfundimit të ditës dhe para fillimit të ditës tjetër në KIPS, pasqyrohet në llogarinë e shlyerjes në KIPS. Në momentin kur KIPS hapet për punë ditën e ardhshme, këto transaksione në sistemin KIPS nuk mund të regjistrohen me datë të vlefshmërisë të ditës paraprake.
5. Për çdo bankë pjesëmarrëse, KIPS hap automatikisht edhe dy llogari të përkohshme teknike; llogaria e kolateralit nga letrat me vlerë për mbështetje ditore (ILF) të likuiditetit, si dhe llogaria për shlyerje të transaksioneve neto të sesioneve të kliringut.
6. Përveç llogarive të cekura në këtë nen, pjesëmarrësit jo banka mund të hapin edhe llogari tjera për shlyerje të transaksioneve, të njohura si PACS llogari.

Neni 36

Mbështetja me hua brenda-ditore për likuiditet

1. Huaja brenda-ditore mund të sigurohet nga BQK kundrejt kolateralit në formën e letrave me vlerë të Qeverisë që mbahen në SRK.
2. SRK njofton KIPS për vlerën e zotimeve të mbajtura për secilin pjesëmarrës. KIPS mban këtë vlerë në një llogari të kolateralit për secilin pjesëmarrës. Kjo vlerë pastaj është në dispozicion të KIPS-it për t'i tërhequr automatikisht gjatë ditës, për të krijuar automatikisht një kredi brenda ditore deri në vlerën e kolateralit të zotuar. Kredia brenda ditore përdoret për të rritur vlerën e mjeteve të disponueshme në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit.
3. Në rastet e aplikimit të kredisë brenda ditore, në fund të ditës pjesëmarrësit duhet të sigurojnë fonde të mjaftueshme në llogarinë e shlyerjes.

Neni 37

Hua njëditore për likuiditet

1. Nëse një bankë nuk është në gjendje të kthejë huan brenda-ditore për likuiditet gjerë në përfundim të ditës së punës në KIPS, BQK-ja mund të zgjatë huan brenda ditore në një hua njëditore për likuiditet për bankën në fjalë, duke aplikuar interes sipas përcaktimit me Politikën e BQK-së për normën e interesit.
2. Me hapjen e sistemeve SRK dhe KIPS dhe fillimit të ditës tjetër të punës, BQK do të kthejë në mënyrë automatike shumën e mbetur të huas, si dhe interesin e aplikueshëm, duke debituar llogarinë për shlyerje të bankës.
3. Banka nuk mund të procesojë operacionet e pagesave nga llogaria e saj për shlyerje përderisa të paguhet të gjitha obligimet që rrjedhin nga huaja për likuiditet njëditor dhe llogaria për shlyerje e bankës të arrijë shumën e kërkesës për rezervën minimale të bilancit për atë ditë.

Neni 38

Veglat për menaxhim të likuiditetit

1. KIPS ofron disa vegla për menaxhimin e likuiditetit të pjesëmarrësve, si në nënparagrafët në vijim:
 - 1.1. Qasja në kohë reale në llogaritë e pjesëmarrësve në KIPS për përdoruesit e pjesëmarrësve;
 - 1.2. Raporte dhe njoftime të ndryshme për monitorimin e rrjedhës së fondeve në llogari të pjesëmarrësve;
 - 1.3. Pjesëmarrësve u mundësohet regjistrimi i parametrave për llogaritje të rezervës së obliguar, si dhe bartja e fondeve ndërmjet llogarive;
 - 1.4. KIPS ofron mundësinë e administrimit të transaksioneve në pritje, si; anulimi i transaksioneve, ndryshimi i prioritetit, përdorimi i kolateralit, etj;
 - 1.5. Përmes KIPS-it ofrohet mundësia e përdorimit të kredisë brenda ditës dhe kredisë një ditore sipas përcaktimeve me rregulloren e BQK për huatë brenda-ditore dhe njëditore;

1.6. Me qëllim që mos të krijohen ngarkesa për përdorim të likuiditetit në fund të ditës, KIPS ofron mundësinë e aplikimit të incentivave në tarifatat për pagesat që dërgohen në pjesën e parë të ditës.

Neni 39

Bilanci minimal i rezervës së obliguar

1. Bazuar në Rregulloren mbi Minimumin e Rezervave të Bankës, BQK cakton një bilanc minimal në llogarinë e bankave pjesëmarrëse. Në sistemin e KIPS-it ky bilanc mbahet në nën-llogarinë e rezervës së detyruar dhe mjetet nga kjo llogari nuk mund të përdoren për qëllime të shlyerjes.
2. Llogaritja e bilancit minimal të rezervës kryhet automatikisht nga KIPS duke u bazuar në parametrat që raportohen paraprakisht nga pjesëmarrësit në këtë sistem, në pajtim me Rregulloren e BQK-së për Minimumin e Rezervave të Bankës, si dhe 50 % e parasë së gatshme që mbahet tek pjesëmarrësit.
3. Parametri i 50% të parasë së gatshme duhet të raportohet nga pjesëmarrësit çdo ditë pune më së largu deri në ora 11:00. Pas raportimit të parë, sipas nevojë pjesëmarrësit mund t'a azhurnojnë këtë parametër disa herë brenda ditës së punës.

Neni 40

Ngjarjet e paparashikuara

1. Ngjarjet e paparashikuara klasifikohen si më poshtë:
 - 1.1. ndërprerja e komunikimit pranë pjesëmarrësit;
 - 1.2. ndërprerja e komunikimit në VPN pranë BQK-së;
 - 1.3. ndërprerje tjera të paparashikuara të sistemit KIPS-it;

Neni 41

Ndërprerja e komunikimit tek pjesëmarrësit

1. Nëse një pjesëmarrës has në vështirësi teknike të cilat pengojnë procesimin e transaksioneve të pagesave ose monitorimin nëpërmjet kompjuter-it në KIPS, ai njofton BQK-në brenda 30 minutave nga momenti i konstatimit të këtyre vështirësive.
2. Pjesëmarrësit njoftojnë menjëherë BQK-në për çdo ndryshim në rrethanat apo në kushtet e operimit me vështirësi.
3. Me marrjen e njoftimit nga pjesëmarrësi, BQK-ja shqyrton problemin dhe udhëzon pjesëmarrësin për mundësitë alternative brenda dy orëve nga pranimi i njoftimit.

Neni 42

Ngjarje të paparashikuara në komunikim

1. Për lidhje me sistemin KIPS, pjesëmarrësit shfrytëzojnë dy lidhje direkte (nga objekti i BQK deri te zyrat kryesore të pjesëmarrësve) VPN me fije optike të ofruar nga dy kompani të ndryshme telekomunikuese vendore.

2. Në raste të ndërprerjes së zgjatur deri në 30 minuta të lidhjes me VPN, BQK njofton pjesëmarrësit me e-mail ose telefon mbi ndërprerjen e sistemit dhe pjesëmarrësit qëndrojnë të lidhur në kompjuter, në mënyrë që të bëhet e mundur marrja e njoftimeve apo e udhëzimeve të nevojshme nga BQK.
3. Në raste kur brenda dy (2) orëve është e pamundur të ri-vendoset lidhja me VPN, pjesëmarrësit nën udhëzimet e BQK-së, vijnë në BQK në mënyrë që të regjistrojnë pagesat e tyre manualisht në pikën e qasjes në KIPS.

Neni 43

Pika e qasjes në Sistemin Ndërbankar të Pagesave

1. Në rastet e dështimit të VPN lidhjeve të cilat u mundësojnë pjesëmarrësve qasjen në KIPS nga lokacionet e tyre, DSP në zyrën e saj operacionale mbanë një pikë të qasjes emergjente për pjesëmarrësit.
2. Nga kjo pikë e qasjes, pjesëmarrësit mund të bëjnë regjistrimin e pagesave RTGS përmes modulit PO, të marrin raporte për rikonsilim, dhe të kryejnë funksione tjera bazike për monitorim të llogarive të tyre. Për qasje në KIPS nga pika e qasjes, përdoruesit e pjesëmarrësve duhet të sjellin e-tokenin e tyre.

Neni 44

Regjistrim i ngjarjeve të paparashikuara

Çdo pjesëmarrës regjistron menjëherë të gjitha ngjarjet e paparashikuara dhe problemet e vërejtura në sistem dhe i raporton ato në BQK më se largu brenda dy (2) ditë pune.

Neni 45

Kalimi në Qendrën për vazhdimësi të biznesit

1. Rastet jo të zakonshme të punës me KIPS kryesisht mund të jenë; rastet e mos funksionimit të plotë të KIPS-së brenda dy (2) orëve, raste ku për shkak të problemeve në infrastrukturën e rrjetit një ose më tepër pjesëmarrës nuk mund të qasen në KIPS, si dhe rastet e jashtëzakonshme kur e tërë infrastruktura e KIPS-it bashkë me stafin e saj nuk mund të operojë nga lokacioni i zakonshëm.
2. Në rastet kur pavarësisht nga mbështetja nga DTI dhe kompania kontraktuese për mirëmbajtje të KIPS-it, problemet e raportuara për mos funksionimin e plotë të KIPS-it nuk mund të zgjidhen brenda dy orëve, atëherë BQK do lidhet me sistemin e KIPS-it që gjendet në qendrën e vazhdueshmërisë së biznesit.
3. Për rastet e jashtëzakonshme kur e tërë infrastruktura e KIPS-it bashkë me stafin dhe zyrën dhe sistemet e tjera në BQK nuk mund të operojnë nga lokacioni i zakonshëm, atëherë BQK mund të vendos për punë nga qendra e vazhdimësisë së biznesit.
4. Në rastet e punës nga qendra e vazhdimësisë së biznesit, BQK njofton institucionet pjesëmarrëse, nga ku pjesëmarrësve sipas nevoje u dërgohen; adresat e reja për qasje në KIPS dhe komponentët e saj, lista e kontakteve për komunikim me stafin e DOSP-së, si dhe detale tjera të nevojshme lidhur me afatet kohore të punës në këtë qendër.

5. BQK kryen së paku një (1) herë në vit, testimet e procedurave për kalimin e KIPS-it në qendrën për vazhdimësi të biznesit.

Neni 46

Ndërprerja e Sistemit të Pagesave Ndërbankare

1. BQK mund të ndërpret pjesërisht apo tërësisht funksionimin e KIPS-it, në rrethana kur vazhdimi i funksionimit të tij do të kishte ndikim negativ mbi stabilitetin e sistemit, duke njoftuar pjesëmarrësit menjëherë.
2. Gjatë periudhës së ndërprerjes së funksionimit të sistemit, operacionet zhvillohen sipas mënyrës së përcaktuar nga BQK.
3. BQK rivendos funksionimin e KIPS-së sa më shpejt që të jetë e mundur, duke njoftuar menjëherë të gjithë pjesëmarrësit.

Neni 47

Administrimi i ndryshimeve dhe kontrolli ndaj tyre

1. Ndryshimet në sistemin KIPS- janë si më poshtë:
 - 1.1. ndryshime funksionale dhe teknike të KIPS-it;
 - 1.2. ndryshime në standardet mesazheve komunikuese;
 - 1.3. ndryshime në VPN, etj.
2. BQK njofton dhe udhëzon pjesëmarrësit para zbatimit të ndryshimeve të planifikuara të KIPS-it, kur këto ndryshime ndikojnë te pjesëmarrësi.
3. Ndryshimet apo përmirësimet e nevojshme në procedurat si dhe në dokumentacionin plotësues të sistemit KIPS-it, u njoftohen pjesëmarrësve.
4. Çdo ndryshim testohet në sistemin për testim, para se të implementohet në sistemin kryesor të KIPS-it.
5. Në rast ndryshimesh në operimin e KIPS-it, lajmërohen paraprakisht të gjithë pjesëmarrësit, duke u dhënë kohën e nevojshme për t'u përgatitur si dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për testimin e lidhjes së sistemeve të tyre me KIPS.
6. BQK, kryesisht ose me kërkesë të argumentuar të pjesëmarrësit, mund të bëjë ndryshime në sistemin e KIPS-it, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të tij.
7. BQK pas shqyrtimit të kërkesës së argumentuar të pjesëmarrësit, e njofton atë për pranimin ose refuzimin e saj, duke e shoqëruar këtë njoftim me argumentimet përkatëse.

Neni 48

Personat e autorizuar

1. Secili pjesëmarrës dorëzon informacionin mbi personat e autorizuar që janë përgjegjës për komunikim me BQK në lidhje me:
 - 1.1. Konfigurimin e përdoruesve;

- 1.2. Ndryshimin e profileve të përdoruesve;
 - 1.3. Fshirjen e përdoruesve nga sistemi;
 - 1.4. Menaxhimin e E-token dhe dërgimin tek përdoruesi i fundit;
 - 1.5. Raportimin e çështjeve operacionale dhe teknike.
2. BQK duhet të përditësojë listën e të gjithë personave të autorizuar të pjesëmarrësve, në një dosje të veçantë.
 3. Për çdo ndryshim në listën e personave të autorizuar, BQK-ja duhet të njoftohet menjëherë nga pjesëmarrësit e KIPS-it.

Neni 49

Mbështetja për përdoruesit e Sistemit të Pagesave Ndërbankare

1. BQK mban një qendër për mbështetjen e përdoruesve të KIPS-it, ku pjesëmarrësit mund të adresohen për problemet e paraqitura gjatë ditës së punës të KIPS-it.
2. BQK informon pjesëmarrësit përmes email-it për personat e kontaktit.
3. Rastet për të cilat do të ofrohet mbështetja kryesisht janë rastet mbi pengesat/ndërprerjet e funksionimit të KIPS-it të cilat vërehen nga stafi i DOSP si dhe rastet të cilat raportohen nga pjesëmarrësit.
4. Për rastet të cilat raportohen nga pjesëmarrësit, personeli përkatës i këtyre institucioneve fillimisht duhet të analizojnë udhëzimet dhe dokumentet teknike mbi funksionimin e KIPS-it që lidhen me problemin e paraqitur. Gjithashtu, nga këta të fundit gjatë raportimit të problemeve duhet të dërgohen informacione të detajuara mbi natyrën e problemit.
5. Rasti raportohet me email në adresën zyrtare për mbështetjen e përdoruesve BQK, ku bashkëngjiten dokumentet sqaruese/faktike për natyrën e problemit.

Neni 50

Përgjegjësia për rastet e jashtëzakonshme

1. Pjesëmarrësit në sistem nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet që rrjedhin nga mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, që vijnë si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara të definuara nga neni 38 i kësaj rregullore, gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të demonstratave, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore.
2. Pjesëmarrësi që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, duhet:
 - 2.1. të njoftojë në BQK me shkrim mbi shkakun dhe shkallën që ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve;
 - 2.2. të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe njëkohësisht, të përpiqet të minimizojë efektet negative të shkaqeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 51

Konfidencialiteti

1. Pjesëmarrësit e sistemit duhet të:
 - 1.1. Zbatojnë rregullat e konfidencialitetit të informacionit mbi të gjitha transaksionet e pagesave të pranuar nga KIPS;
 - 1.2. Pjesëmarrësit e KIPS-it mund të shkëmbejnë informacione me çdo pjesëmarrës tjetër, në lidhje me çdo aspekt të funksionimit apo administrimit të këtij sistemi;
 - 1.3. Secili nga pjesëmarrësit trajnojnë personelin përkatës, të cilët kanë të drejta për përdorimin e informacionit mbi transaksionet e pagesave të pranuar në sistemin KIPS për ruajtjen e konfidencialitetit mbi këtë informacion, në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe me dispozitat e kësaj rregullore;
 - 1.4. BQK dhe pjesëmarrësit, ushtrojnë të njëjtin nivel përkujdesjeje, për mbrojtjen e informacionit të konsideruar si konfidencial nga një palë tjetër;
 - 1.5. Dispozitat e këtij neni zbatohen nga pjesëmarrësit dhe BQK, edhe pas mbylljes së llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit.

Neni 52

Tarifat për Sistemin e Pagesave Ndërbankare

1. Bankat dhe pjesëmarrësit tjerë në KIPS do të paguajnë tarifën për shërbimet e ofruara nga ky sistem, si; kycja në KIPS, tarifën për mirëmbajtjen e lidhjeve telekomunikuese, tarifën për realizimin e transaksioneve të pagesave ndërbankare, tarifën për mirëmbajtjen e përdoruesve, dhe ndonjë tarifë tjetër që mund të caktohet nga BQK-ja.
2. Për transaksionet e dërguar në KIPS në pjesën e parë të ditës së punës, BQK aplikon zbritje në përqindje në raport me tarifën kryesore të aplikuar për atë lloj të transaksioneve të pagesave.
3. Për çdo transaksion të dërguar në KIPS, BQK ngarkon tarifën e transaksionit vetëm për institucionin dërgues, përderisa për institucionin pranues nuk aplikohet tarifë.
4. Tarifat në KIPS kalkulohen në baza ditore, ndërsa fatura me totalin ditëve për një muaj të caktuar ekzekutohet në ditën e parë të punës së muajit vijues, përmes debitimit të llogarisë së pjesëmarrësve në KIPS.
5. Të gjithë pjesëmarrësit në sistem e pagesave mund të nxjerrin nga ky sistem faturat e llogaritura në baza ditore për një muaj të caktuar dhe njëkohësisht mund të shohin transaksionin i cili ka debituar llogarinë e tyre për vlerën e faturës të ekzekutuar në ditën e parë të muajit në vijim.
6. BQK njofton pjesëmarrësit me e-mail për ekzekutimin e faturës për tarifën e një muaji, në një ditë nga dy ditët e para të punës së muajit në vijim.
7. Për pagesat ndërbankare të procesuara përmes KIPS-it, banka përfituese e transaksionit nuk do të ngarkojë me tarifë klientët e saj për transaksionet e pranuar, me përjashtim të rasteve të pagesave kolektuese, si Giro, Debitimi Direkt apo lloje tjera të pagesave të cilat bëhen me marrëveshje për ndarjen e tarifës.
8. Tarifat e shërbimeve të KIPS-it mund të ndryshohen nga BQK dhe do të publikohen së paku një muaj para vlefshmërisë së tyre.

Neni 53

Udhëzimet për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare

Në kuadër të kornizës të përcaktuara në këtë rregullore, varësisht si vlerësohet e nevojshme, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Kosovës nxjerrë udhëzimet për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare.

Neni 54

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Sistemin e Pagesave Ndërbankare e miratuar nga Bordi i BQK-së me 01 gusht 2018.

Neni 55

Shtojcat

1. Bashkangjitur kësaj rregulloreje janë shtojcat:
 - 1.1. Letërpëlqim për pjesëmarrje në Sistemin e Pagesave Ndër-bankare – KIPS;
 - 1.2. Aplikacion për përdorues dhe e-token.

Neni 56

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet

Çdo shkelje e dispozitave e kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për BQK-në dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

Neni 57

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës



Letërpëlqim për pjesëmarrje në Sistemin e Pagesave Ndërbankare – KIPS

Me këtë Letërpëlqim pjesëmarrësi pajtohet me kriteret si në vijim:

1. Pjesëmarrësi do t'i respektojë dhe do të zbatojë rregulloren e sistemit të KIPS-it dhe udhëzimit operacionale përkatëse;
2. Pjesëmarrësi konfirmon pranimin e kopjes së Rregullores të KIPS-it dhe se është i njoftuar me udhëzimet për përdorim të KIPS-it;
3. Pjesëmarrësi zotohet të mos ndikojë negativisht në efikasitetin e KIPS-it dhe në integritetin e transaksioneve të pagesave të dërguara dhe pranuar, shlyerjen e atyre transaksioneve apo të rrezikoj sistemin KIPS;
4. Pjesëmarrësi merr përsipër të paguajë tarifat dhe pagesat e tjera të detyrueshme të caktuara në kuadër të rregullativës përkatëse të BQK-së;
5. Të drejtat dhe detyrimet e parapara në këtë letërpëlqim nuk janë vetëm për sistemin KIPS, por vlejné edhe për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë që janë pajtuar t'i respektojnë dhe të zbatojné rregulloren e KIPS-it, marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse;
6. Pjesëmarrësi me këtë dokument e autorizon BQK-në të administrojë me llogaritë e tij të mbajtur në KIPS me qëllim të funksionimit të duhur të këtij sistemi;
7. Për përdorim të sistemit të KIPS-it pjesëmarrësit duhet të plotësojnë aplikacionin, si në vijim:

Aplikacioni për pjesëmarrje në KIPS	
Për:	Departamentin e Sistemit të Pagesave Banka Qendrore të Republikës së Kosovës
Nga:	Emri i aplikuesit:
	Vendi:
	Numri i biznesit:
	Adresa e zyrës qendrore :
	SWIFT BIC:
	Llogaria për shlyerje:
	Kontakt personi për operacione në sisteme të pagesave :
	Numri i telefonit:

	Numri i faksit:	
	E-mail:	
	Kontakt personi për shërbime të IT-së	
	Numri i telefonit:	
	Numri i faksit:	
	E-mail:	
	Data e preferuar e fillimit: <i>(Kjo është data e preferuar nga kur aplikuesi dëshiron të filloj përdimin e KIPS-it.)</i>	

Nënshkrimi nga pjesëmarrësi:

Emri i plotë i drejtorit:	Nënshkrimi:	Data:

Aplikacion për përdorues dhe e-token

Për:	Departamentin e Sistemit të Pagesave Banka Qendrore të Republikës së Kosovës	
Nga:	Emri i pjesëmarrësit	
	Emri i personit kontaktues:	
	Numri i telefonit	
	E-mail:	
Të dhënat për llojin e kërkesës dhe përdoruesin		
Lloji i kërkesës:	<input type="checkbox"/> Hapje e përdoruesit <input type="checkbox"/> E-token i ri <input type="checkbox"/> Mbyllja e përdoruesit <input type="checkbox"/> Ri-instalim certifikate në E-token <input type="checkbox"/> Resetim i fjalëkalimit <input type="checkbox"/> Dorëzim i E-tokeni <input type="checkbox"/> Resetim i fjalëkalimit në E-token	
Sistemi:	<input type="checkbox"/> ATS <input type="checkbox"/> PO	
Emri përdoruesit:		
Përdoruesi/username		
Lloji i përdoruesit	<input type="checkbox"/> <i>Operator</i> <input type="checkbox"/> <i>Administrator</i>	
Pozita dhe vendi i punës:		
E-mail dhe telefoni		
Detaje tjera mbi kërkesën, arsyeshmëria		
Të dhënat e miratuesit të kërkesës nga pjesëmarrësi		
Emri dhe pozita:	Nënshkrimi:	Data:

Aprovimi nga BQK

DSP:	DTI:	Data:
------	------	-------